



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

RELACION

**-PËR MIRATIMIN E NJE TRANSFERIMI NË BUXHETIN E VITIT 2024,
MIRATUAR ME VKB NR. 44, DATË 15.12.2023.**

Të nderuar Këshilltar!

Grupi Menaxhimit Strategjik të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH”, neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9936, dt.26.06.2008”, i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, propozon transferim të buxhetit të vitit 2024, të miratuar me VKB-nr. 44, datë 15.12.2023, sipas tabelës të pasqyruar në projekt-vendim.

Ndryshimet konsistojnë në pakësimin e fondit për paga në programin buxhetor -Planifikim Menaxhim Administrim, dhe shtesën në zërin shpenzime operative po në këtë program buxhetor.

Me vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.40, datë 26.08.2024, është miratuar transferim buxheti nga artikulli 602 në artikujt 600 paga, 601 sigurime shoqërore dhe 231 investime, me burim financimi të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore. Vlera e transferimit për fondin e pagave u përcaktua nga të dhënat paraprake të Ministrisë Financave për mbështetjen me fonde nga buxheti shtetit, vlerë kjo 3,500,000 lekë me pak se akordimi i fondit për kompesimin e efektit financiar nga rritja e pagave. Meqënëse Ministria e Financave na akordojë 3,500,000 lekë më tepër se vlera paraprake, propozojmë që për këtë vlerë të pakësojmë zërin buxhetor - Paga dhe të shtojmë zërin buxhetor – shpenzime operative. Ky transferim bënë të mundur balancimin e buxhetit, dhe gjithashtu nëse plani i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore realizohet në nivelin e parashikuar edhe shpenzimet e planifikuara do të realizohen sipas parashikimit.

Ju faleminderit

